



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:176913

Datë: 26.11.2024

Numri i dokumentit: 06512880

KPPP.nr. 984/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania “Dauti Komerc” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810655524 dhe seli në Magjistralen Ferizaj Kaçanik, kundër debitorit Komuna e Mitrovicës me seli në Mitrovicë, të cilin e përfaqëson Arbnor Murturi, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 470/24, i lejuar me datë 27.05.2024, nga Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka, me seli në Kaçanik, jashtë seancës me datë 26.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Mitrovicës me seli në Mitrovicë ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 470/24, i lejuar me datë 27.05.2024 nga Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka, ANULOHET

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania “Dauti Komerc” Sh.P.K., në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr. 25732, e datës 16.11.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, në emër të borxhit sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 189.60 EUR, me kamatë ligjore duke filluar nga data e kalimit të afatit për pagesë, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbartimit pasi që i njëjti nuk përmban elementet të

cilat përcaktohen me nenin 43, par. 2 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se fatura në bazë të së cilës është iniciuar procedura përmbartimore nuk është e përshtatshme për përmbartim ngase e njëjta nuk është pranuar në mënyrë të rregullt dhe nuk është vulosur nga personi kompetent pranë debitorit dhe si e tillë është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori, andaj nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, sipas nenit 27 të LPP-së. Duke u bazuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Komerciale, faturat duhet të jenë të protokolluara nga institucionet publike për t'u konsideruar që janë pranuar në mënyrë të rregullt. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri për përmbartim të anulohet, si dhe të obligohet kreditori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetimin se urdhri përmbartimor është lejuar në bazë të faturës e cila është në origjinal, është pranuar, nënshkruar dhe vulosur nga debitori, ashtu që e njëjta ka të gjitha tiparet e përmbartueshmërisë. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri për përmbartim të mbetet në fuqi, si dhe të detyrohet kreditori që të kompensojë shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Urdhri Përmbartimor P.nr. 470/24 i datës 27.05.2024 është mbështetur në Faturën nr. 25732 të datës 16.11.2023, e cila nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm për faktin se fatura e lartcekur nuk është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori përmes vulës së pranimit të shkresave të debitorit si

institucion publik. Si rezultat i kësaj, Gjykata erdhi në përfundim se Fatura nr. 25732, e datës 16.11.2023, mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi nuk është e përshtatshme për përmbarim dhe nuk paraqet bazë për lejimin e përmbarimit.

Gjykata pati parasysh faktin se në faturën objekt i këtij përmbarimi është i evidentuar një nënshkrim tek pranuesi i faturës por meqenëse në rastin konkret kemi të bëjmë me debitorin si institucion publik, vërtetimi i pranimit të kësaj fature nga kjo e fundit mund të provohet vetëm përmes dorëzimit të saj tek zyra e pranimit të shkresave të debitorit, apo eventualisht ndonjë pagese të pjesshme të faturës kontestuese, rrethana këto që nuk janë prezente në rastin konkret.

Nga të lartcekurat, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 984/24, datë 26.11.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.